



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 167, Datë 28.06.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 935/5 prot., datë 23.06.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 90, datë 28.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/15 prot., datë 29.04.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.05.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 469/2 prot., datë 06.05.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/5 prot., datë 20.05.2022 dhe nr. 495/6 prot., datë 24.05.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin shtesë.
- Në kuptim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 149, datë 10.06.2022, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. duhej të depozitonte në ERE, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit, vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sikurse përcaktuar në nenin 9, pika 2, gërma “d” të rregullores së sipërcituar.

- Brenda afatit të përcaktuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470/2 prot., datë 20.06.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat "a", "b" dhe "c".
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat "a", "b", "c" dhe "e".
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat "a", "b", "c" dhe "d".
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.7, gërmat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h" dhe "i".
- ***Për sa i përket kërkesave të nenit 9, pika 2, gërma "d"***, lind nevoja që shoqëria të informojë ERE-n çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor.
- ***Për sa i përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, gërma "e"***, referuar marrëveshjes së përcjellë nga shoqëria "Salillari Energy Trade" sh.p.k., të lidhur me shoqërinë mëmë, ku përcaktohet që kjo e fundit merr përsipër që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, që me stafin dhe mjetet e saj të instalojë sistemin IT në fushën e energjisë për këtë shoqëri, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE informacion mbi instalimin konkret të këtij sistemi.
- ***Për sa i përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, gërma "g"***, që ka të bëjë me dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë depozitimi jo më vonë se data 01.03.2023 i kontratës së rinovuar së disponimit të zyrave për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve, (data e fundit e vlefshmërisë së saj).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë "Salillari Energy Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.

3. Shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. të informojë ERE-n, çdo tre muaj në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.
4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 01.03.2023.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI